REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____Prot., Tiranë, më __.__.2026

V E N D I M

Nr.21, datë 29.10.2026

PËR

"DHËNIEN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL TË PËRKOHSHËM PËR PËRDORIMIN E SASISË SË SPEKTRIT 2X5 MHZ (FDD) NË BREZIN 2600 MHZ, PËR STUDIM, KËRKIM, PROVE DHE EKSPERIMENTIM TË SHËRBIMEVE D2D-IMT" SIPËRMARRËSIT "ONE ALBANIA SH.A"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Anëtar**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 29.10.2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" miratuar me vendimin nr. 11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme shqyrtoi çështjen me objekt:

- Dhënien e autorizimit individual të përkohshëm për përdorimin e sasisë së spektrit 2x5 MHz (FDD) në brezin 2600 MHz për studim, kërkim, provë dhe eksperimentim të shërbimeve D2D-IMT, sipërmarrësit "One Albania" sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 11 e nenit 66 dhe neni 131, të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
2. VKM nr. 756, datë 13.12.2024, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave" (PKF);
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.7, datë 06.09.2023 për miratimin e "Planit të Përdorimit të Frekuencave (PPF)";
4. Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 2563, datë 11.05.2015 (nr.810/12 prot., datë 11.05.2015) "Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit "Albania Mobile Communications" sh.a për katër të drejta përdorimi nga 2x5 MHz spektër i çiftuar në brezin 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS" me afat vlefshmërie 15 vjet nga miratimi i saj (sot One Albania sha);

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor i përbërë si më poshtë:

1. Aplikimi me nr. reference 2026-AKEP-SS-11.1_104, datë 25.09.2026, protokolluar në AKEP me nr. 1949 prot., datë 01.10.2026, për pajisjen me autorizim individual për përdorimin e frekuencave për qëllime studimi, kërkimi, prove dhe eksperimentimi në këtë brez, si dhe shkresën me nr. 1860 prot., datë 25.09.2026, administruar në AKEP me nr. 1903 prot., datë 28.09.2026, me lëndë: "Aplikim për Autorizim Eksperimental Radio për Komunikimet Satelitore Direkt-në-Pajisje (D2D) në bandën ekzistuese të spektrit 2.6 GHz (2525–2530/2645–2650 MHz)" i operatorit One Albania sh.a;
2. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin;
3. Projektvendimin e Këshillit Drejtues në përfundim të shqyrtimit të aplikimit, të përgatitur nga struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

1. Sipërmarrësi "One Albania" sh.a., ka kërkuar pajisjen me autorizim individual të përkohshëm për përdorimin eksperimental të spektrit të frekuencave në brezin 2600 MHz (sasinë 2×5 MHz (FDD)), për qëllime studimi, kërkimi, prove dhe eksperimentimi të shërbimeve D2D-IMT, si dhe caktimin e një kodi MNC, si pjesë e identifikuesit të rrjetit celular PLMN ID, të dedikuar për shërbimin D2D-IMT gjatë fazës së testimit.
2. Referuar informacionit dhe të dhënave teknike të paraqitura nga sipërmarrësi ONE Albania sh.a. në dokumentacionin e aplikimit, kërkesa për përdorimin eksperimental të frekuencave dhe realizimin e testimeve D2D-IMT ka si objekt përdorimin eksperimental të një blloku spektri prej 2×5 MHz (FDD) në brezin 2600 MHz për testimin e komunikimeve satelitore Direct-to-Device (D2D), si dhe integrimin teknik të sistemit satelitor me rrjetin celular të ONE Albania sh.a. Frekuencat e kërkuara janë konkretisht 2525–2530 MHz, në drejtimin Tokë–

Hapësirë, për transmetimin nga terminali celular drejt satelitit dhe 2645–2650 MHz, në drejtimin Hapësirë–Tokë, për transmetimin nga sateliti drejt terminalit celular.

3. Afati i vlefshmërisë së autorizimit individual të përkohshëm është kërkuar për një afat prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 11 të nenit 66 të ligjit nr. 54/2024.
4. Operatori "ONE Albania" sh.a. në kuadër të testimeve që do të kryejë kërkon edhe caktimin e një kodi MNC (Mobile Network Code), me qëllim identifikimin e rrjetit në kuadër të realizimit të testimeve të kërkuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të pajisë sipërmarrësin "One Albania" sh.a., me Autorizim Individual për përdorimin e sasisë së spektrit 2x5 MHz (FDD) në brezin 2600 MHz (2525–2530/2645–2650 MHz), për studim, kërkim, provë dhe eksperimentim të shërbimeve D2D-IMT, sipas Shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të pajisë sipërmarrësin "One Albania" sh.a., me kodin MCC/MNC 276 04, sipas Shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual dhe i përdorimit të kodit MCC/MNC, për testimin e shërbimit celular bazuar në rrjet satelitor (D2D-IMT) është 120 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ngarkohet administrata e AKEP për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bvleron Dokle**	**Diana Dervishi**

SHTOJCA 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AUTORIZIM INDIVIDUAL

Nr. _____, datë ___.___.2026

SIPËRMARRËSI:

"ONE ALBANIA" sh.a.

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM FREKUENCASH PËR STUDIM, KËRKIM, PROVË DHE EKSPERIMENTIM

KRYETARI

Gentian Sala

ANEKS Nº 8/1

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM FREKUENCASH PËR STUDIM, KËRKIM, PROVË DHE EKSPERIMENTIM

Te dhenat e Sipermarresit	
Emri i Personit Fizik/ Juridik	**One Albania sh.a**
Adresa Postare	Rruga "Muhedin Llagami" Kompleksi Square 21
Qyteti/ Shteti	Tiranë/ Shqipëri
NIPT-i	J61814094W
Data e Regjistrimit në QKR	27/11/1995
Telefon	00355672016603
E-Mail	aplikimeakep@one.al
Personi i kontaktit	Ilir Duka
Telefon	00355682024008
E-Mail	iduka@one.al; ervin.shpori@one.al; loreta.pistolja@one.al; luan.sula@one.al;marjola

Të dhënat e Aktivitetit	
Qëllimi i aktivitetit	Qëllimi i testimeve është të vendosë, verifikojë dhe testojë integrimin teknik ndërmjet rrjetit celular të operatorit ONE Albania sh.a. dhe rrjetit satelitor të SpaceX, funksionet e kontrollit të rrjetit dhe sistemit, si proceset operacionale të shërbimit që lidhen me kartat SIM të caktuara për qëllimet e testimit.
Nr. i pjesëmarrësve në aktivitet	Testi do të përdorë sistemin satelitor jo-gjeostacionar Direct-to-Device VI të SpaceX dhe një numër të kufizuar terminalesh celularë komercialisht të disponueshëm, të pamodifikuar, dhe me aftësi të teknologjisë LTE.
Zona gjeografike	Në të gjithë territorin e Shqipërisë
Numri i stacioneve fikse gjatë aktivitetit	Sistemi satelitor SpaceX Direct-to-Device VI LEO Terminali 1: Apple iPnone 14 Pro Terminali 2: Samsung Galaxy S26 Ultra

Të dhënat e Frekuencave	
Brezi i Frekuencave [GHz]	2525-2530 çiftuar 2645-2650 MHz
Gjerësia e Kanalit [MHz]	5 MHz
Frekuencat e Caktuara [MHz]	2525-2530 MHz: drejtimi Tokë-Hapsirë (transmetim nga aparati celular)
	2645-2650 MHz: drejtimi Hapsirë-Tokë (transmetimi nga sateliti)

Të dhënat e të stacionit radio satelitor SpaceX	
Parametri	**Vlerë**
Emri i sistemit	Sistemi satelitor SpaceX Direct-to-Device VI LEO
Operator teknik	SpaceX

Teknologjia e radios	D2D i bazuar në LTE, me funksionalitetin satelitor eNodeB
Orbita e satelitit	Orbita e ulët jo-gjeostacionare e Tokës
Lartësia orbitale	340-360 km
Ekcentricitet	~0
Frekuenca e transmetimit hapësirë-Tokë	2645-2650 MHz
Frekuenca e marrjes Tokë- hapësirë	2525-2530 MHz
Gjerësia e brezit e aktivizuar (MHz)	5 MHz
Modaliteti i dyfishtë	FDD
Lloji i antenës	Antenë me dipole të sfazuara
Përforcimi maksimal i antenës	38 dBi
EIRP maksimale e downlink-ut	58 dBW
Dendësia maksimale e fluksit të fuqisë në sipërfaqen e Tokës	-80 dBW /m2/MHz
Përcaktuesi i emetimeve	5M00G7W
Toleranca e frekuencës	0.002%
Depozitime te lidhura me ITU-në	USASAT-NGSO-MULS dhe USASAT-NGSO-MULS2
Satelitë pjesëmarrës në test	650

Të dhënat e terminaleve mobile	
Terminali 1	
Parametri	**Vlerë**
Prodhuesi dhe modeli	Apple iPnone 14 Pro
Numri i modelit	A2890
Natyra e terminalit	Telefon celular 4G/LTE/5G i disponueshëm komercialisht, pa modifikime hardware
Teknologjia e radios dhe brezi i frekuencave	LTE FDD, 3GPP Band 7
Frekuenca e transmetimit Tokë- hapësirë	2525-2530 MHz
Frekuenca e marrjes hapësirë- Tokë	2645-2650 MHz
Gjerësia e brezit të kanalit (MHz)	5 MHz
Fuqia maksimale e transmetimit	23 dBm
Antenë	Antenë mobile e integruar; pa antenë satelitore të jashtme
Përmasat	147,5 x 71,5 x 7,85 mm
Pesha	0,206 kg
SIM	SIM-të e testimit të paracaktuara

Të dhënat e terminaleve mobile	
Terminali 2	
Parametri	**Vlerë**
Prodhuesi dhe modeli	Samsung Galaxy S26 Ultra
Numri i modelit	SM-S948B/DS
Natyra e terminalit	Telefon celular 4G/LTE/5G i disponueshëm komercialisht, pa modifikime hardueri; mbeshtetje per nano-SIM dhe eSIM

Teknologjia e radios dhe brezi i frekuencave	LTE FDD, 3GPP Band 7
Frekuenca e transmetimit Tokë- hapësirë	2525-2530 MHz
Frekuenca e marries hapësire- Tokë	2645-2650 MHz
Gjerësia e brezit të kanalit (MHz)	5 MHz
Fuqia maksimale e transmetimit	23 dBm nominale (klasa e fuqisë LTE 3)
Modulimi dhe përcaktuesi i emetimeve	Lidhje LTE lart SC-FDMA
Antenë	Antenë mobile e integruar; pa antenë satelitore të jashtme
Përmasat	163,6x 78.1 x mm
Pesha	0,214 kg
SIM	SIM-të e testimit të paracaktuara

Mbrojtja nga interferencat

Bazuar në nenin 4.4 të Radio Rregullores së ITU, stacioni të mos shkaktojë interferenca të dëmshme dhe të mos kërkojë mbrojtje nga stacionet që operojnë në përputhje me këtë Radio Rregullore.

Afati i përdorimit të Frekuencave

Koha e përdorimit të frekuencave të caktuara nga AKEP: Fillon / / Mbaron / /

SHTOJCA 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

NJOFTIM

Nr. _____, datë ___.___.2026

"PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI"

SIPËRMARRËSIT:

"ONE ALBANIA" SH.A

KRYETARI

Gentian Sala

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
One Albania sh.a		**J61814094W**
Adresa Postare		**Data e Regjistrimit në QKB**
Rruga "Muhedin Llagami" Kompleksi Square 21, Tiranë		**27.11.1995**
Qyteti / Shteti		**Kutia Postare**
Tiranë / Shqipëri		**-**
Telefon	**Fax**	**E-mail**
00355672016603	**-**	iduka@one.al; ervin.shpori@one.al; loreta.pistolja@one.al
Personi i Kontaktit		
Ilir Duka		
Telefon	**Fax**	**E-mail**
00355682024008	**-**	iduka@one.al;

Në kategorinë e kodeve të rrjeteve të lëvizshëm (MNC) për operatorët e rrjeteve telefonike publike të lëvizshëm, caktohet për përdorim kodi:

MCC	MNC	OPERATORI
276	**04**	ONE ALBANIA sh.a

MCC Mobile Country Code
MNC Mobile Network Code